



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD – NR. 10/2023¹ PËR RENDIN
SHTËPIAK NË INSTITUCIONET KORREKTUESE**

¹ Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë më datë 15.09.2023.

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 32, neni 37 (paragrafi 5), neni 61 (paragrafi 6), neni 64 (paragrafi 2), neni 65 (paragrafi 3), neni 67 (paragrafi 3), neni 91 (paragrafi 2), neni 184 (paragrafi 1), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 së Republikës së Kosovës,

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 10/2023 PËR RENDIN SHTEPIAK NË INSTITUCIONET KORREKTUESE

KAPITULLI I DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ (më tej: Udhëzimi) rregullohet rendi shtëpiak, organizimi dhe mënyra e jetës së personave të dënuar dhe të paraburgosur në institucionet korrektuese.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Ky Udhëzim zbatohet në të gjitha Institucionet Korrektuese, për personat e dënuar dhe të paraburgosur gjatë mbajtjes së dënimit apo masës së paraburgimit.

2. Ky Udhëzim zbatohet përshtatshëmrisht edhe për të burgosurit të cilët qëndrojnë përkohësisht jashtë institucionit korrektues.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim kanë kuptimin si në vijim:

1.1. **I dënuari**-personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale.

1.2. **I paraburgosuri**-personi të cilit i është shqiptuar masa e paraburgimit.

1.3. **Institucionet Korrektuese** - Qendrat e Paraburgimit dhe Qendrat Korrektuese si dhe Burgu i Sigurisë së Lartë.

1.4. **I burgosuri** - të gjithë personat e privuar nga liria të cilët gjenden në institucionet korrektuese.

Neni 4

Përshtatshmëria e dispozitave ligjore

1. Dispozitat e këtij Udhëzimi zbatohen përshtatshëmrisht edhe ndaj të paraburgosurve dhe të miturve nëse me Kodin përkatës të Drejtësisë për të Mitur dhe Kodin përkatës të Procedurës Penale nuk është përcaktuar ndryshe.

2. Dispozitat e Kodit përkatës të Procedurës Penale dhe dispozitat e Ligjit përkatës për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) zbatohen përshtatshëmrisht edhe në mënyrën e veprimit me personat e dënuar dhe të paraburgosur.

Neni 5

Respektimi i dispozitave ligjore

1. Personat e dënuar dhe të paraburgosur janë të detyruar që t'iu përmbahen dispozitave të këtij Udhëzimi dhe urdhrave nga zyrtarët kompetent.

2. I gjithë stafi përgjegjës në Institucionet Korrektuese në kuadër të kompetencave të tyre duhet të sigurohen për zbatimin e dispozitave të këtij Udhëzimi.

KAPITULLI II

PRANIMI DHE VENDOSJA E PERSONAVE TË DËNUAR DHE TË PARABURGOSUR

Neni 6

Pranimi

1. Në institucionin korrektues pranohet vetëm personi për të cilin gjykata kompetente ka nxjerr aktvendim për caktimin e masës së paraburgimit, ose kur gjykata ka shqiptuar me aktgjykim dënimin me burgim dhe i ka lëshuar urdhër institucionit korrektues që atë person ta pranojë për ekzekutimin e sanksionit penal, masës së paraburgimit ose të masës tjetër.

2. Instrukcioni korrektues mban regjistrin për pranimin e personit të dënuar ose të paraburgosurit në të cilin shënohet emri, emrin e prindërit dhe mbiemrin e personit të dënuar ose të paraburgosur, dita dhe ora e pranimi, emri dhe mbiemri personit zyrtar të autorizuar i cili personin e dënuar ose të paraburgosurin e ka sjellë në Instrukcionin Korrektues dhe emri dhe mbiemri i zyrtarit korrektues i cili në instrukcionin korrektues e ka pranuar personin e dënuar ose të paraburgosurin.

3. Zyrtari kompetent për pranimin e të burgosurit gjatë procedurës së pranimi e bënë fotografimin e tij në tri profile, mat peshën fizike dhe gjatësinë, shënon të dhënat personale, shenjat e veçanta, tatuazhet dhe shenjat e tjera nëse i ka duke përfshirë lëndimet.

4. Nëse zyrtari i autorizuar i instrukcionit korrektues me rastin e pranimi konstaton se personi i dënuar ose i paraburgosuri është i lënduar apo deklaron se urgjent i nevojitet intervenimi i mjekut, atëherë kërkon nga personi zyrtar i autorizuar i cili e ka sjellë në instrukcionin korrektues të sigurojë raport mjekësor të instrukcionit shëndetësor jashtë instrukcionit korrektues.

5. Në rast se personat e autorizuar që e kanë sjellë të burgosurin nuk mund të sigurojnë raportin mjekësor nga jashtë, atëherë i burgosuri pranohet në instrukcion dhe menjëherë kërkohet nga stafi mjekësor ekzaminimi i të burgosurit në pranim.

6. Nëse personi i dënuar është sjellë në instrukcionin korrektues në bazë të urdhërarrestit, instrukcioni korrektues në afatin më të shkurtë do ta informojë gjykatën kompetente.

7. Pas kontrollimit mjekësor të burgosurit i jepet mundësia të pastrohet dhe i sigurohen rroba, veshmbathje, ndërresa dhe çarçafë të pastër.

8. Nëse pranimi i personit të burgosur bëhet pas orarit të rregullt të punës i njëjti vendoset në dhomën e veçantë deri në ditën vijuese të punës, kur do të kryhen veprime të nevojshme nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 7

Verifikimi i identitetit

1. Me rastin e pranimi të personit të dënuar ose të paraburgosur në instrukcionin korrektues verifikohet identiteti i tij në bazë të letërnjoftimit, pasaportës, ose patentë shoferit.

2. Nëse i paraburgosuri/dënuari nuk ka asnjë dokument identifikimi në bazë të cilit mund të verifikohet identiteti i tij atëherë garantues për identitetin e tij do të jetë personi i autorizuar zyrtar i cili e ka shoqëruar deri në instrukcionin korrektues për çka përpilohet shënim i veçantë në formularin zyrtar, i cili përmban të dhënat të cilat duhet të jenë në përputhje me të dhënat e vendimit të gjykatës kompetente. Ky dokument nënshkruhet nga personat zyrtar të cilët e kanë dorëzuar dhe pranuar. Menjëherë pas pranimi, bëhet verifikimi i identitetit përmes Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit në kuadër të Policisë së Kosovës.

3. Personi i cili vjen vullnetar në mbajtje të dënimit i cili nuk posedon dokument identifikimi nuk do të pranohet në Instrukcion Korrektues për derisa nuk bëhet verifikimi i identitetit të tij nga Policia e Kosovës.

4. Dokumentet në bazë të të cilave është vërtetuar identiteti i personit të burgosur, do të ruhen në dosjen e tij.

Neni 8 **Kontrollimi i të burgosurit**

1. Pas vërtetimit të identitetit, nga zyrtari korrektues i institucionit korrektues, kryhet kontrollimi i personit të burgosur dhe i sendeve të tij personale. Nëse ekziston dyshimi i bazuar që personi i burgosur posedon mjete të pa lejuara duhet të bëhet edhe kontrollimi i hapjeve trupore të personit të burgosur dhe atë e kryen personeli shëndetësor me kërkesën e drejtorit të institucionit korrektues.

2. Kontrollimin personal nga paragrafi 1 i këtij neni duhet ta bëjnë vetëm personat zyrtar të gjinisë së njëjtë, gjini së cilës i takon personi i dënuar ose i paraburgosuri.

3. Kontrollimi i të burgosurit bëhet nga dy zyrtarë në atë mënyrë në të cilën respektohet personaliteti dhe dinjteti i tij.

4. Kontrolli personal dhe kontrollimi i trupit kryhet në pajtim me nenin 34 të Ligjit.

Neni 9 **Regjistrimi i të dhënave**

1. Në institucionin korrektues mbahet regjistri në librin amë të pranimit, si dhe regjistrimi elektronik në bazën për të gjithë të burgosurit që janë në mbajtje.

2. Në librin amë dhe bazën e të dhënave shënohen të dhënat për secilin person të dënuar ose të paraburgosur.

3. Nëse personi i dënuar është sjellë në institucionin korrektues me urdhëresë nga gjykata apo letër-rreshtim, pas pranimit në institucionin korrektues në afatin më të shkurtë do ta informojë gjykatën kompetente.

Neni 10 **Sendet të cilat i lejohen personit të dënuar ose të paraburgosur**

1. Personat e dënuar dhe të paraburgosur me rastin e pranimit të tyre në institucionin korrektues u lejohen gjësendet e caktuara në dhomat e tyre.

2. Sendet të cilat i lejohen personit të dënuar dhe të paraburgosur janë:

2.1. Mjetet për mbajtjen e higjienës personale (sapuni, brusha dhe pasta për dhëmbë, shamponi për flokë, gota plastike, krehëri dhe mjeti për prerjen e thonjve), ndërsa personave të dënuar ose të paraburgosur të gjinisë femërore edhe mjetet higjienike-

mbështetjet higjienike, ndërsa nga preparatet kozmetike kremra për duar dhe kremra për fytyrë;

2.2. Mjetet e rrojës përpos briskut të rrojës dhe mjete të tjera përkatëse të rrojës, ndërsa personave të dënuar ose të paraburgosur femra turpia për thonjtë e gjatësisë deri në 3 cm, pinceta, brusha për flokë, tharëse për flokë;

2.3. Mjetet për pastrimin dhe mbajtjen e rrobave;

2.4. Cigare dhe çakmak;

2.5. Laps, laps kimik dhe letër;

2.6. Mjetet ortopedike, syzet, e sipas rekomandimit të mjekut edhe barnat e domosdoshme pas aprovimit të Drejtorit të Institucionit Korrektues;

2.7. Veshëmbathjet përfshirë veshjet sportive (fanella pa mëngë, pantollona të shkurtra, trenerka dhe atlete);

2.8. Unaza e martesës dhe orë e dorës në vlerë të ulët.

2.9. Fotografitë familjare, shkresat dhe dokumentacioni mjekësor si dhe dokumentacioni gjyqësor.

2.10. Sendet për kryerjen e ritualeve fetare;

2.11. Gjësendet e tjera sipas tipit të institucionit dhe nivelit të tretmanit; si dhe

2.12. Gjësendet të cilat kanë të drejtë t'i blejnë përmes kantinës.

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk i lejohet orë e mençur.

Neni 11

Marrja përrkohësisht e sendeve

1. Nëse personi i burgosur sjell sende të cilat nuk mund t'i mbajë ose sendet e tilla i pranon gjatë mbajtjes së dënimit, të njëjtat do të merren përrkohësisht, dhe i njëjti obligohet që sendet e palejuara t'i kthejë tek familjarët. Të burgosurit janë të obliguar që çdo gjësend që e kanë në depozitë dhe që konsiderohet i panevojshëm ta kthejnë tek familjarët.

2. Marrja e sendeve regjistrohet në formularin përkatës që shërben si vërtetim për sendet e marra, si dhe një kopje i dorëzohet të burgosurit.

3. Në rast se duhet të asgjësohet ndonjë send merret pëlqimi i të burgosurit, në rast se asgjësimi i ndonjë sendi është i domosdoshëm ai duhet të asgjësohet dhe të regjistrohet në formularin përkatës dhe njoftohet i dënuari.

4. Nëse sendet e palejueshme kanë lidhje me veprën penale, institucioni korrektues do ta njoftojë organin kompetent.

Neni 12 **Ruajtja e sendeve të marra përkohësisht**

1. Sendet e marra nga i dënuari ruhen në lokalin e caktuar të institucionit korrektues (depozitë) për t'i siguruar nga prishja dhe dëmtimi.
2. Paratë dhe sendet e çmueshme mbahen në kasafortën ose në vendin tjetër të sigurt, të cilin e cakton drejtori i institucionit korrektues, por që paraprakisht bëhet regjistrimi i tyre me numër serik dhe vlerën e tyre.

Neni 13 **Kthimi i sendeve**

1. Kur kryhet kthimi i sendeve të personit të burgosur nga depozita nëpërmjet vizitës familjare, apo postës, përveç sendeve të palejueshme të marra me rastin e kontrollimit, personi zyrtar i ngarkuar me depo është i detyruar që kopjen e formularit ta dërgojë me sendet, ndërsa kur kthimi kryhet drejtpërdrejt, një kopje e formularit i dorëzohet personit i cili pranon sendin.
2. Në kopjen tjetër të formularit i cili mbetet në depozitë, pranim-dorëzimi vërtetohet me nënshkrimet e pranuesit dhe dorëzuesit të sendit.
3. Zyrtari i cili është i ngarkuar me depo është i detyruar që me rregull të mbajë evidencën për sendet të cilat i ka pranuar për ruajtje, si dhe për sendet të cilat i ka kthyer.
4. Me rastin e lirimit të burgosurit nga Institucioni Korrektues, i kthehen sendet e marra përkohësisht, për çka përpilohet procesverbal. Një kopje e formularit i dorëzohet personit.

Neni 14 **Kontrolli mjekësor**

Menjëherë pas pranimi në institucionin korrektues, e më së voni në afat prej njëzetë e katër (24) orësh apo në ditën e parë të punës pas pranimi, do të bëhet kontrolli i përgjithshëm mjekësor i të burgosurit. Me kërkesën e të burgosurit, apo për shkak të pengesave të vërejtura shëndetësore gjatë pranimi, kontrolli mjekësor bëhet pa shtyrje.

Neni 15 **Pavijoni i pranimi**

1. Pas pranimi në institucionin korrektues personi i dënuar dërgohet në pavijonin e pranimi, në të cilin mund të mbahet deri në tridhjetë (30) ditë.

2. Në pavijonin e pranimit për personin e dënuar formohet lista personale, në të cilën shënohet numri amë në institucionin korrektues dhe të dhënat për personin e dënuar.

3. Në pavijonin e pranimit të burgosurit i bëhet vlerësimi i sigurisë si dhe sistemimi i tij në pavijonin përkatës, duke marrë parasysh vlerësimin e rrezikut dhe nevojave që është kryer për të dënuarin ku përcaktohet trajtimi bazuar në planin individual të dënimit.

4. Nga i burgosuri kërkohet që të deklarojë të dhënat e sakta për veten dhe anëtarët e familjes së ngushtë me adresat e sakta dhe numrat e telefonave nëse i posedon, me qëllim të regjistrimit në listën personale dhe në kartonin e vizitave. Nëse nuk e dinë adresën e saktë dhe numrat e telefonave të anëtarëve të familjes së ngushtë, kërkohet që t'i sigurojë me rastin e vizitës dhe t'i deklaroj tek zyrtari kompetent i Institucionit Korrektues.

Neni 16

Vendosja e personave të dënuar

1. Personat e dënuar vendosen në institucionet korrektuese në pajtim me vlerësimin e rrezikut, nevojave dhe planit individual të dënimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar, moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore dhe veçoritë tjera karakteristike të të dënuarve. Nëse është e mundur, të dënuarit vendosen në institucionin korrektues, i cili është afër vendbanimit të tij/saj.

2. Caktimin e personave të dënuar nëpër dhoma e bënë drejtori i institucionit korrektues ose i autorizuari i tij.

3. Personat e dënuar nuk mund të vendosen në të njëjtin krahë të pavijonit me të paraburgosurit.

4. Të paraburgosurit për veprën e njëjtë penale në bashkëkryerje, si rregull nuk vendosen në dhomë të njëjtë. Përjashtimisht, në mungesë të hapësirës, mund të vendosen nëse gjykata kompetente nuk ka urdhëruar ndryshe.

5. Personat e dënuar dhe të paraburgosurit të cilët janë recidivist në kryerjen e veprave penale nuk vendosen në dhomë të njëjtë me personat e dënuar ose të paraburgosur, të cilët më herët nuk kanë qenë në mbajtjen e dënimit-me burg për aq sa është e mundur.

6. Personat e mitur vendosen ndaras prej personave madhor. Personat e mitur të paraburgosur ose të dënuar nuk do të vendosen në mbajtje me personat e tjerë të mitur.

Neni 17

Ndarja e personave të burgosur

1. Personi i dënuar ose i paraburgosuri mund të mbahet ndaras nga të tjerët edhe nën këto rrethana:

1.1 kur atë e kërkon gjendja e tij shëndetësore, ose e të tjerëve;

1.2 kur kjo është paraparë me ndonjë ligj tjetër;

1.3.kur këtë personi i dënuar ose i paraburgosuri e kërkon me qëllim të mbrojtjes personale dhe sipas lejes së drejtorit të institucionit korrektues;

1.4. për të siguruar integritetin e hetimit të ndonjë çështje disiplinore;

1.5. nëse ai person paraqet kërcënim serioz për rendin në institucionin korrektues.

2. Ndarja nga personat e dënuar bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit.

Neni 18

Vendosja për shkak të sëmundjeve infektive

I burgosuri i cili vuan nga sëmundja infektive ose nga ndonjë sëmundje tjetër që infektohen lehtë, vendosen veçmas prej personave të dënuar ose të paraburgosur të tjerë, dhe për këtë vendos drejtori i institucionit korrektues me propozimin e mjekut të institucionit korrektues.

Neni 19

Akomodimi brenda dhomës

1. Institucioni korrektues të burgosurit i siguron shtratin, dyshekun, jastëkun me këllëf, çarçafë dhe një (1) batanije gjatë stinës së verës, dy (2) batanije gjatë periudhës së dimrit, varësisht nga ngrohja.

2. Të dënuarit i sigurohet dollap i vogël, respektivisht ndarje e posaçme në dollap, ose pjesë e posaçme e orendisë për mbajtjen e sendeve të cilat mund t'i ketë me vete.

3. Nga i burgosuri kërkohet që dhomën në të cilën është i akomoduar ta mbajë pastër, përfshirë shtratin dhe gjësendet e tjera personale.

4. Shtretërit duhet të jenë të rregulluar, ndërsa sendet personale me rregull të jenë të vendosur në dollapin për sendet personale.

Neni 20

Hapësira e jetesës për të burgosur

1. Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për dhomë të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në dhomë të përbashkëta dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore, artificiale për punë, lexim, ngrohje dhe ajrosje.

2. Dhomat duhet të kenë dritare për ndriçim të mjaftueshëm, të cilat mundësojnë hyrjen e ajrit të pastër dhe të dritës, e cila i mundëson personit të dënuar leximin në dritën natyrore në kushtet e rëndomta.

3. Të burgosurit dalin për ajrosje në ambient të hapur çdo ditë të javës, jo më pak se dy (2) orë në ditë në vendin e caktuar sipas rutinës ditore.
4. Në rastet e veçanta, ose për të burgosurit e sëmurë, me rekomandim të mjekut lejohet të dalin për ajrosje më gjatë se koha dhe orari i përcaktuar me rutinën ditore, pasi mjeku të shpjegoj me shkrim arsyet e dhënies së kohës shtesë për ajrosje për afatin e përcaktuar.
5. Kufizimi i orarit të ajrosjes bëhet vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të Drejtorit të Institucionit Korrektues.

Neni 21 **Veshmbathja**

1. Personi i burgosur ka të drejtë për ndërresa, rroba, këpucë pa pagesë, të përshtatshme për kushtet vendore klimatike dhe stinën e vitit.
2. Në raste të veçanta kur personi i dënuar nuk ka dhe nuk mund t'i siguroi vetë veshmbathjet, institucioni korrektues është i obliguar t'i siguroj ndërresat, rrobat dhe këpucët që duhen t'i përgjigjen kushteve klimatike dhe stinës së vitit.
3. I dënuari mund të pranoj veshmbathje përmes vizitës dhe t'i kthej rrobat e tepërta që i ka pasur në dhomë me qëllim të mos grumbullimit.
4. Lista e veshmbathjeve të lejuara për personat e dënuar caktohet nga Drejtori i Institucionit Korrektues.
5. I dënuari mundet të pranoj veshmbathje sipas nevojës nga vizitorët. Veshmbathja duhet të jetë në përputhje me standardet e dhomës. Veshmbathja duhet të kontrollohet nga stafi përgjegjës në prani të vizitorit për shkaqe sigurie.
6. Të dënuarit që nuk realizojnë vizita familjare, ju lejohet pranimi i veshmbathjeve me postë. Pako duhet të përmbajë të dhënat e plota të personit që e dërgon pakon, në të kundërtën nuk do të pranohet në Institucionin Korrektues.
7. Ndalohen veshmbathjet me ngjyrën e uniformës së stafit dhe të burgosurit, apo që paraqesin rrezik për rendin dhe sigurinë në Institucionin Korrektues dhe janë vështirë për t'u kontrolluar.

Neni 22 **Orari ditor**

Të gjitha aktivitetet ditore përcaktohen dhe zhvillohen sipas rutinës ditore të miratuar nga drejtori i institucioni korrektues.

Neni 23
Njohja me rendin shtëpiak

1. Pas pranimit, institucioni korrektues është i obliguar që të siguroj kushtet në të cilat personi i dënuar, njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar i cili nuk dinë shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht dhe nëse është e mundur në gjuhën të cilën e kupton i dënuari.
2. Ligji përkatës për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe ky Udhëzim Administrativ janë në dispozicion të personave të dënuar gjatë tërë kohës sëmbajtjes së dënimit.
3. Sipas kërkesës së personit të dënuar ose të paraburgosur mund t'i mundësohet që të njihet edhe me Kodin përkatës Penal të Republikës së Kosovës, Kodin përkatës të Drejtësisë për të Mitur dhe Kodin përkatës e Procedurës Penale.
4. Kopjet e kodeve nga paragrafi 3 i këtij neni do të jenë në dispozicion të çdo personi të dënuar sipas kërkesës së tij, në çdo kohë të arsyeshme. Me rastin e pranimit në institucionin korrektues, çdo person i dënuar, informacionet me shkrim do t'i pranoj në gjuhën që e kupton për mënyrën se si do t'i siguron ato.

KAPITULLI III
USHQIMI, MBROJTJA SHËNDETËSORE, DHE ZBATIMI I MASAVE
HIGJIENIKE

Neni 24
Ushqimi

1. Institucioni korrektues është i obliguar që të gjithë të burgosurve të ju sigurohen tri shujta në ditë, njëra prej këtyre shujtave duhet të jetë ushqim i ngrohtë.
2. Të burgosurve ju sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, punën dhe stinën dhe aq sa është e mundur kërkesave të tij fetare dhe kulturore.
3. Cilësia e ushqimit kontrollohet çdo ditë nga stafi shëndetësor.

Neni 25
Kantina e të Burgosurve

1. Institucionet Korrektuese sigurojnë ambiente të përshtatshme për kantinë, e cila furnizohet me artikuj të ndryshëm sipas kontratës të lidhur mes Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe operatorit ekonomik.

2. Të burgosurit mund të blejnë gjësende nga kantina në vlerën e përcaktuar sipas trajtimit përkatës.
3. Procedura për blerje në kantinë përcaktohet nga drejtori i Institucionit Korrektues, ndërsa menaxhohet nga zyrtari përgjegjës për kantinë në Institucionin Korrektues.

Neni 26 **Shpërndarja e ushqimit**

1. Ushqimi përgatitet dhe servohet në mjedise të caktuara për këtë qëllim.
2. Personit të burgosur të sëmurë, të miturve, shtatëzënave, ushqimi u sigurohet në pajtim me rekomandimin e mjekut.
3. Norma e ushqimit ditor përcaktohet me menynë mujore.
4. Të burgosurve duhet t'u sigurohet nëvazhdimësi ujë i pijshëm.

Neni 27 **Higjiena**

1. Të burgosurve ju sigurohen pajisje dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë personale, si:
 - 1.1. një (1) sapun;
 - 1.2. një (1) mjet për rrojë i cili do të mbahet në dhomën e zyrtarëve korrektues, nëse nuk është e caktuar ndryshe nga Drejtori i Institucionit Korrektues;
 - 1.3. një (1) pastë dhe një brushë rroje;
 - 1.4. një (1) shishe plastike shampon;
 - 1.5. një (1) pastë dhe brushë për dhëmbë; dhe
 - 1.6. një (1) krehër.
2. Përpos pajisjeve higjienike të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni i dënuari në rast nevoje mund të mbaj edhe pajisjet higjienike si në vijim:
 - 2.1. shampon dhe pampersa për bebe;
 - 2.2. vata higjienike mujore për femra;
 - 2.3. pampersa për të rritur.

3. Çdo institucion siguron shërbime periodike të pastrimit të hapësirave, veshmbathjes dhe pajisjeve personale, si dhe të qethjes.
4. Qethja mund të bëhet me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjieno - sanitare, sipas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.
5. I burgosuri është i obliguar që për çdo ditë të mbajë higjienën personale dhe të përgjithshme.
6. I burgosuri është i obliguar që ta mbajë higjienën në lokalet në të cilat qëndrojnë, sipas rutinës të përcaktuar nga institucioni korrektues.
7. Çarçafët dhe këllëfi i jastëkut, ndërrohen dhe pastrohen të paktën një herë në dhjetë (10) ditë, ndërsa batanijet së paku një herë në tre (3) muaj. Rrobat dhe ndërresat personale të personit të burgosur pastrohen dhe thahen në lavanderinë e institucionit.
8. Drejtori i Institucionit Korrektues siguron dhe ndërmerrë masa që dhomat dhe ambientet e përbashkëta të jenë të pastërta. Muret e objekteve të brendshme të banimit duhet të mirëmbahen dhe sipas nevojës të gëlqerosen dhe dezinfektohen.
9. Kontrolli higjieno-sanitar i dhomave dhe ambienteve të përbashkëta bëhet nga personeli mjekësor.

Neni 28

Mbrojtja shëndetësore

1. Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të burgosurve. Administrata e institucionit korrektues siguron kushtet dhe hapësirën për mbrojtje shëndetësore.
2. Pajisjet dhe barërat me produktet medicinale sigurohen nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve i Ministrisë përkatëse për mbrojtjen e shëndetit të të burgosurve.
3. Organizmi dhe funksionimi i shërbimeve shëndetësore bëhet në pajtim me Ligjin përkatës për Shëndetësi.
4. Institucioni korrektues nëpërmjet institucionit përkatës shëndetësor pranë Ministrisë përkatëse, personit të dënuar i siguron mbrojtje shëndetësore që është përcaktuar me ligj.
5. Nëse në nivel të institucionit korrektues nuk ekzistojnë kushte për mjekim të suksesshëm të sëmundjeve të caktuara, personi i dënuar dërgohet në institucionin shëndetësor në të cilën ekzistojnë kushte përkatëse.
6. Konstatimi i mjekut shënohet në dosjen shëndetësore të të burgosurit.
7. Çdo institucion ka shërbim shëndetësor farmaceutik, që i përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të dënuarve.
8. Të dënuarit, që dyshohen ose kanë sëmundje ngjitëse, izoloohen menjëherë në mjedise të posaçme.

9. Në institucionet ku mbajnë dënimin gratë, funksionojnë shërbimet speciale mjekësore në shërbim të grave shtatzëna dhe nënave gjdhënëse.

10. Personeli mjekësor viziton çdo ditë të dënuarit e sëmurë kur ata bëjnë kërkesë dhe kontrollon periodikisht të gjithë të dënuarit e tjerë. Personeli mjekësor njofton menjëherë për sëmundjet që kërkojnë trajtim të specializuar.

11. Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit korrektues, të dënuarit transferohen në spitalin (stacionaret) e burgjeve dhe kur është e nevojshme, ata transferohen në institucionet publike shëndetësore sipas shkallshmërisë së referimit bazuar në Ligjin përkatës për Shëndetësi.

12. Diagnostikimi dhe trajtimi në këto institucione bëhet sipas rregullit të brendshëm të këtyre institucioneve të përcaktuar në Ligjin përkatës për Shëndetësi dhe rregullore përkatëse për këtë qëllim.

13. Në rastet urgjente institucioni korrektues thërret qendrën emergjente më të afërt, kur rrezikohet jeta e të burgosurve, ndërmerren të gjitha masat e trajtimit urgjent për dërgimin në institucionin shëndetësor sipas shkallshmërisë së referimit të Ligjit përkatës për Shëndetësi.

14. Përjashtimisht në rast kur emergjenca njofton se nuk mund t'i përgjigjet kërkesës me kohë, apo lajmëron se do të ketë vonesa, atëherë institucioni korrektues në bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit korrektues mund t'a përcjellë të burgosurin në institucionin shëndetësor më të afërt.

Neni 29 **Kërkesa për vizitë mjekësore**

1. Për vizitë mjekësore personi i dënuar i lajmërohet personelit mjekësor, e në mungesë të tij zyrtarit korrektues të pavijonit. Në rastet urgjente, pas orarit të punës, kujdestari i institucionit korrektues pas konsultimit me mjekun dhe rekomandimin e tij, me aprovimin e drejtorit, personin e dënuar mund ta dërgoj për trajtim mjekësor jashtë institucionit.

2. Lajmërimi i të dënuarit për vizitë mjekësore bëhet çdo mëngjes tek infermieri në detyrë, e në mungesë të tij te zyrtari korrektues i cili e përcjell në ambulancën e burgut.

3. Infermieri e bënë triazhimin e pacientëve për t'u kontrolluar nga mjeku. Mjeku bënë vizitën mjekësore në përputhje me parimin e konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.

4. Të gjitha të dhënat shëndetësore evidentohen dhe ruhen në dosjen shëndetësore të pacientit, e cila është dokument konfidencial mjekësor.

5. Dokumentacioni mjekësor të cilën personi i dënuar e ka sjell me vete në institucionin korrektues, i dërgohet institucionit tjetër korrektues në rast të transferimit. Sipas kërkesës së personit të dënuar institucioni korrektues është i obliguar t'ia sigurojë kopjen e dokumentacionit për gjendjen e tij shëndetësore.

Neni 30 Terapia

1. Mjeku përcakton terapinë dhe mënyrën e dhënies.
2. I burgosuri është i detyruar që të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe higjienës, si dhe t'i përmbahet udhëzimeve të mjekut në zbatimin e mjekimit dhe të pengimit të sëmundjeve ngjitëse.
3. I burgosuri është i detyruar të zbatojë udhëzimet e mjekut gjatë terapisë.
4. Pa dijeninë e mjekut, i burgosuri nuk mund të mbajë e të përdorë asnjë lloj medikamenti mjekësor përveç me rekomandim të mjekut dhe aprovim të Drejtorit të Institucionit Korrektues.
5. Dhënia e terapisë në pavijone bëhet nga personeli mjekësor në prani edhe të zyrtarëve korrektues.

Neni 31 Shërbimi stomatologjik

1. Të gjithë të burgosurit kanë të drejtë të marrin shërbime stomatologjike bazike në ambulancat e institucionit korrektues nga mjeku stomatolog.
2. Për shërbimet bazike stomatologjike, që nuk kryhen në këto ambulanca, bëhet referimi për në institucione publike, në pajtim me Ligjin.
3. Për shërbimet e specializuara stomatologjike që nuk mund të ofrohen në institucionet publike, me kërkesë të të burgosurit dhe në bazë të rekomandimit mjekësor dhe miratimit të drejtorit të institucionit korrektues, i burgosuri mund të dërgohet për trajtim në institucione private mundësisht në qytetin më të afërt me selinë e institucionit korrektues.
4. Transporti bëhet nga institucioni korrektues dhe shoqërohet nga zyrtarët korrektues e në raste të caktuara edhe nga personeli mjekësor.
5. Trajtimi shëndetësor i të burgosurve jashtë institucioneve shëndetësore të institucionit korrektues dhe atyre publike, lidhur me shpenzimet e caktuara bëhet në pajtim me Ligjin përkatës për Sigurime Shëndetësore.

Neni 32 Barnat mjekësore, sigurimi dhe shpërndarja e tyre

1. Pas vizitës mjekësore, mjeku i institucionit korrektues ose mjeku specialist sipas llojit të sëmundjes, përcakton mjekimin e nevojshëm, i cili evidentohet në dosjen mjekësore dhe përshkruhen barërat e nevojshme.

2. Trajtimi me barërat mjekësore bëhet nga ambulanca e institucionit korrektues, ndërsa shpërndarja bëhet nga personeli mjekësor.

3. Në mungesë të barnave në institucion korrektues, ose me kërkesë të veçantë për barëra me emër komercial, i burgosuri ka të drejtë që t'i blejë barnat me shpenzimet e veta ose t'i pranojë prej familjes së vet ose prej personave të tjerë. Barnat e pranuar për të burgosurin i dorëzohen personelit shëndetësor, para përdorimit duhet patjetër t'i kontrollojë mjeku i institucionit korrektues, i cili e cakton terapinë sipas udhëzimit të specialistit, i cili i ka caktuar barnat dhe cakton mënyrën e ruajtjes së barnave.

Neni 33

Izolimi mjekësor

1. Në rastet e sëmundjeve ngjitëse mjeku vendos për izolimin e të burgosurit, duke e mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm dhe menjëherë njoftohet drejtori i institucionit korrektues për situatën.

2. Në rastet e konstatimit se i burgosuri është i infektuar me sëmundje infektuese, dhoma dezinfektohet, ndërsa i burgosuri izolohet në një ambient të veçantë ose dërgohet në spitalin e burgut për mjekim të specializuar.

3. Mjeku vendos për përfundimin e izolimit kur nuk ekzistojnë më shkaqet që ndikuan në vendosjen e tij.

Neni 34

Dërgimi për në Qendrën Spitalore të institucionit korrektues dhe institucionet tjera të kujdesit shëndetësor publik

1. Dërgimi i burgosurit të sëmurë për në Qendrën Spitalore të institucionit korrektues ose në institucione të tjera të kujdesit shëndetësor publik, kryhet nga zyrtarët korrektues, e në raste të jashtëzakonshme i shoqëruar nga personeli shëndetësor i institucionit korrektues.

2. I burgosuri, referohet në stacionarin e burgut, institucionin për trajtimin e personave me nevoja të veçanta ose në institucione të kujdesit shëndetësor publik sipas indikacioneve dhe rekomandimeve të mjekut.

3. Mënyra e transportit të burgosurit në institucione të kujdesit shëndetësor bëhet konform nevojave shëndetësore dhe indikacioneve gjegjëse.

KAPITULLI IV MËNYRA E PLOTËSIMIT TË NEVOJAVE FETARE

Neni 35 Plotësimi i nevojave fetare

1. Të burgosurit kanë të drejtën e besimit fetar dhe të ushtrimit të riteve fetare. Për ushtrimin e riteve, institucioni korrektues siguron hapësira të veçanta.
2. I burgosuri mund të pranojë përfaqësuesit e bashkësive fetare me qëllim të plotësimit të nevojave të veta fetare dhe shpirtërore. Vizita bëhet në lokalet për vizita, ose nëse ekziston në institucionin korrektues, në lokalin e veçantë i rregulluar vetëm për atë destinim.
3. Vizitat nga paragrafi 1 i këtij neni, kryhen nën mbikëqyrjen e zyrtarit të autorizuar të institucionit korrektues.
4. Nëse në institucionin korrektues nuk ekziston lokali i veçantë për plotësimin e nevojave fetare të të burgosurit, ceremoninë fetare (lutjen) mund ta kryej në dhomë.
5. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk duhet të prishet rendi, disiplina dhe siguria e përgjithshme në institucionin korrektues, as të fyhet ndjenja fetare ose nacionale e burgosurit.

KAPITULLI V KORRESPONDENCA, PRANIMI I VIZITAVE DHE I PAKOVE

Neni 36 Korrespondenca

1. Personi i dënuar gëzon të drejtën për korrespondencë.
2. Personi i dënuar gëzon të drejtën e privatësisë së letrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit.
3. Letra, ose dërgesa tjetër postare mund të hapet nëse ekziston dyshimi i bazuar se në të gjendet ndonjë send i palejuar.
4. Personit të dënuar i mundësohet të jetë i pranishëm gjatë hapjes së letrës, ose dërgesës tjetër postare dërguar atij, ose nga ai në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni. Në rastin kur ai nuk është i pranishëm informohet menjëherë. Kur hapja e letrës, ose e dërgesës tjetër postare bëhet në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, përmbajtja e tyre kontrollohet vetëm atëherë sa është e nevojshme për nxjerrjen e konstatimit, nëse letra, ose dërgesa tjetër postare përmban ndonjë send të palejuar.

5. Drejtori i institucionit korrektues mund të nxjerr vendim me shkrim për autorizimin e hapjes, leximit të letrës, ose dërgesës tjetër postare si masë më së paku shqetësuese e mundshme nëse ekziston dyshim i bazuar se në të ka prova për:

5.1. veprim që do të rrezikonte sigurinë e institucionit korrektues, ose të ndonjë personi;

5.2. veprë penale, apo plan për kryerjen e veprës penale; dhe

5.3. hapja dhe leximi i letrës, ose i dërgesës postare është masa më së paku e bezdisshme e mundshme në ato rrethana.

6. Kur letra, ose dërgesa tjetër postare hapet dhe lexohet në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni, drejtori i institucionit korrektues menjëherë e informon me shkrim personin e dënuar lidhur me arsyet e veprimit të tillë dhe atij i mundëson të jep sqarime lidhur me këtë, përveç nëse informata do të ndikonte në mënyrë të pafavorshme në hetimet e papërfunduara, me ç'rast personi i dënuar informohet për arsyet dhe atij i mundësohet dhënia e sqarimeve lidhur me këtë me përfundimin e hetimeve.

7. Letra, ose dërgesa postare që është hapur dhe lexuar në pajtim me paragrafin 5 të këtij neni mund të ndalohet, nëse do të rrezikohej siguria e institucionit korrektues, ose e ndonjë personi. Në rastin e tillë personi i dënuar informohet menjëherë dhe, në rastin e ndalimit të letrës, ose të dërgesës postare pasuese, ai informohet për përmbajtjen e saj deri në masën e nevojshme.

8. Letra që është ndaluar i dorëzohet personit të dënuar sapo të pushojë së ekzistuari baza për ndalimin e saj dhe më së voni deri në fund të mbajtjes së dënimit të tij, përveç nëse gjykata kompetente vendos ndryshe. Kundër vendimit të gjykatës, lejohet ankesë në gjykatën kompetente. Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit.

9. Letrat dhe dërgesat tjera postare nga personi i dënuar që i adresohen Avokatit të Popullit nuk kontrollohen.

Neni 37

Administrimi i korrespondencës

1. Institucioni Korrektues cakton zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe administrimin e korrespondencës së të burgosurve duke i vendosur ato në zarf të mbyllur në një kuti adekuate postare.

2. Nëse personi i dënuar dëshiron të dërgoj një parashtrësë e cila duhet të pranohet brenda një afati të caktuar kohor, ai duhet ta dorëzojë atë tek personi përgjegjës i stafit të institucionit korrektues, i cili duhet ta konfirmoj datën e pranimit përmes shënjitimit të zarfit, apo përmes shënjitimit të parashtrësës, në rastet kur është dorëzuar pa zarf.

Neni 38

Adresimi i parashtrësave

1. Parashtrësat që i adreson i burgosuri mund t'i dërgohen menaxhmentit të institucionit korrektues, Shërbimit Korrektues të Kosovës, gjykatës apo organeve tjera shtetërore, pa zarf

dhe pa vulë, mirëpo korrespondencat për tek të gjitha adresat tjera, duhet të dërgohen në zarf të mbyllur.

2. Personi zyrtar i institucionit korrektues, i cili e pranon parashtresën e adresuar tek menaxhmenti apo administrata e institucionit korrektues, duhet ta shënoj datën e pranimit, ta vendos nënshkrimin e tij, dhe ta dorëzoj atë tek personi përgjegjës për dërgimin e postës.

Neni 39 **Korrespondenca me avokatin**

Personi i paraburgosur dhe ai i dënuar mund të kontaktojë me avokatin e tij pa kufizim dhe pa mbikëqyrjen e përmbajtjes së korrespondencës.

Neni 40 **Korrespondenca me Avokatin e Popullit**

1. Korrespondenca e të burgosurit me Avokatin e Popullit të Kosovës është e privilegjuar që do të thotë se nuk duhet të kontrollohet në asnjë mënyrë.

2. Avokati i Popullit ka të drejtë korrespondence me të paraburgosurin ose të dënuarin në çdo kohë dhe pa paralajmërim.

3. Avokati i Popullit i ka të vendosura kutitë e ankesave dhe parashtresave në secilin Institucion Korrektues, të cilat mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni.

4. Institucioni Korrektues i siguron qasje të pa penguar të burgosurit për realizimin e të drejtës për parashtrimin e ankesës dhe kërkesave në kutinë e Avokatit të Popullit.

Neni 41 **Informimi**

1. Të burgosurit në institucionet korrektuese kanë të drejtën e informimit.

2. Të burgosurit duhet të informohen për rregullat e institucionit si dhe për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë mbajtjes së dënimit.

3. Të burgosurit ju jepet mundësia e leximit të literaturës, shtypit si dhe përcjellja e mediave dhe i'u mundësohet blerja me mjete vetanake të gazetave ditore dhe revistave përmes kantinës.

4. Institucioni Korrektues mund kufizoj qasjen në informim në pajtim me nenin 86, paragrafi 5 të Ligjit.

Neni 42 **Vizitat dhe kontrollimi i vizitorëve**

1. Personi i dënuar ka të drejtë që të pranojë vizita së paku një herë në muaj në kohëzgjatje prej së paku një (1) orë. Zgjatja e vizitës do të përcaktohet varësisht nga trajtimet në të cilat është i vendosur i burgosuri.

2. I burgosuri ka të drejtë të vizitohet nga bashkëshorti/bashkëshortja, fëmija, fëmija i adaptuar, prindërit, prindërit adaptues, dhe të afërmit tjerë të gjakut në vijë të drejtë ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, si dhe nga personat tjerë me lejen e Drejtorit të Institucionit Korrektues.
3. Të burgosurit mund të vizitohen edhe nga personat zyrtar të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Të burgosurit të cilët janë në lidhje të ngushtë familjare mes vete mund të realizojnë vizita nga një institucion në tjetrin, me kërkesën e tyre pas rekomandimit të drejtorëve të Institucionit Korrektues dhe me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
5. Zyrtari Korrektues duhet të kryejë kontrollin e të gjithë vizitorëve. Kontrollimi i vizitorëve bëhet nga zyrtari i gjinisë së njëjtë.
6. Kontrollimi bëhet me pajisje teknike të sigurisë dhe prekje.
7. Vizita kryhet në ditët dhe kohën sipas radhës që e përcakton drejtori i institucionit korrektues.
8. Në rastin kur rrezikohet institucioni apo shëndeti, jeta e personave të burgosur, personelit, shfaqjes së ndonjë epidemie, drejtori i institucionit korrektues mundet përkohësisht të ndalojë të gjitha vizitat dhe për atë njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues. Personave të dënuar me shpenzimet e institucionit korrektues do t'i mundësohet që t'i informojnë anëtarët e familjes për ndalimin e vizitës.
9. Personat të cilët vijnë në vizitë tek personi i dënuar duhet të figurojnë në listën e vizitorëve në dosjen e të burgosurit, të cilët i lejon zyrtari i autorizuar i institucionit korrektues.
10. Nëse i burgosuri ose vizitori e shfrytëzon vizitën në mënyrën e cila mund të jetë e dëmshme për zhvillimin e procedurës penale, ose me sjelljen e vet e prish disiplinën dhe sigurinë e përgjithshme, zyrtari i autorizuar i institucionit korrektues i cili kryen mbikëqyrjen ndërprende vizitën.

Neni 43 Vizitorët

1. Vetëm personat që ndodhen në listën e vizitorëve të burgosurit, apo ata që autorizohen nga gjykata dhe Drejtori i Institucionit Korrektues lejohen të vizitojnë të burgosurin.
2. Vizitat e të paraburgosurve bëhet me lejen e Gjykatës në pajtim me rendin dhe orarin e përcaktuar nga Drejtori i Institucionit Korrektues.
3. Të dhënat e vizitorëve të lejuar duhet të regjistrohen në kartelën e vizitorëve e cila duhet të evidentohet edhe në databazë.
4. Para vizitës së të dënuarit, vizitorët duhet t'i depozitojnë në një dollap të gjitha gjësendet që ata i kanë me vete. Ata duhet ta mbyllin dollapin me çelës të cilin e marrin kur të arrijnë për vizitë dhe duhet ta kthejnë atë kur të largohen.

5. Personi i dënuar i cili dëshiron që t'ua jap vizitorëve gjësendet personale ose ndonjë artikull tjetër, duhet që së pari t'i dorëzojnë ato gjëra për inspektim brenda njësisë.

Neni 44 **Ndalimi i vizitave**

1. Drejtori i Institucionit Korrektues është kompetent për të ndaluar vizitat për shkaqe të arsyeshme.

2. Shkaqet e ndalimit përkohësisht të vizitave janë:

2.1. Në rast të informacionit se i burgosuri, apo vizitori gjatë realizimit të vizitës mund të rrezikoj sigurinë e institucionit apo të vizitorëve.

2.2. Në rast të informacionit për planifikim ose të kryerjes së ndonjë vepre penale;

2.3. Në rast se vizitori bënë përpjekje që të fus kontrabandë në institucion;

2.4. Vizitat që paraqesin kërcënim për shëndetin fizik dhe mendor për të burgosurin dhe vizitorin;

2.5. Në rastet kur vërtetohet se ka bërë shkelje të mëparshme të rregullave të vizitës;

2.6. Në çdo rast tjetër që mund të paraqes rrezik për institucionin apo vizitorët.

3. Drejtori i Institucionit Korrektues me vendim përcakton kohëzgjatjen për ndalimin e vizitës varësisht prej shkaqeve për të cilat është ndaluar.

4. Drejtori i Institucionit Korrektues duhet ta informoj të burgosurin dhe vizitorin për arsye e ndalimit të vizitës.

5. Ndalimi i vizitës nuk konsiderohet masë disiplinore.

Neni 45 **Ndërprerja e përgjithshme e vizitave**

1. Drejtori i Institucionit Korrektues pasi njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, bënë ndërprerjen e përgjithshme të vizitave për të gjithë të burgosurit kur siguria e institucionit është e rrezikuar dhe nëse nuk ka alternativë tjetër kufizuese në dispozicion.

2. Ndërprerja e përgjithshme e vizitave duhet të vazhdoj përdherisa vazhdon rreziku.

3. Në rast të shfaqjes së ndonjë sëmundje epidemiologjike në vend, me qëllim të parandalimit të përhapjes në institucion korrektues, Drejtori i Institucionit Korrektues në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme bënë ndalimin e përkohshëm të vizitave.

Neni 46 **Qëndrimi në lokale të veçanta**

1. Personi i dënuar ka të drejtë së paku një herë në tre (3) muaj të qëndroj me bashkëshortin/bashkëshorten dhe me fëmijët të paktën tre (3) orë në lokalet e veçanta të institucionit korrektues.

2. Lokali i veçantë i institucionit korrektues duhet të jetë mjaftueshëm i gjerë, i ngrohur, i ndriçuar, me mobile të nevojshme, banjën dhe e përshtatur për qëndrim të personave dhe me mjete mbrojtëse të nevojshme.

Neni 47 **Përfituesit nga e drejta për kalimin e kohës në lokalet e veçanta**

1. Të drejtën për kalimin e kohës në lokale të veçanta kanë të dënuarit.

2. Personat që kanë të drejtë vizite në lokalet e veçanta janë bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët e të dënuarit.

Neni 48 **Procedura për realizimin e vizitës në lokalet e veçanta**

1. Të gjithë personat e dënuar duhet të informohen me shkrim nga institucionet korrektuese për realizimin e të drejtës, kushtet dhe rregullat të cilat duhet të plotësohen nga i dënuari lidhur me lejimin apo refuzimin për kalimin e kohës në lokalet e veçanta.

2. Personi i dënuar parashtron kërkesë me shkrim për kalimin e kohës në lokale të veçanta tek autoritetet e institucionit korrektues.

3. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet certifikata e lëshuar nga organi kompetent (zyra e gjendjes civile), me të cilën dëshmohet ekzistimi i martesës apo bashkësisë jashtëmartesore, ndërsa për fëmijët të sigurohet certifikata/ekstrakti i lindjes, ose certifikata e bashkësisë familjare.

4. Komisioni profesional shqyrton kërkesën dhe i rekomandon drejtorit, lejimin apo refuzimin e kërkesës së të dënuarit për kalimin e kohës në lokale të veçanta.

5. Pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit Profesional, Drejtori i Institucionit Korrektues merr vendim lidhur me kërkesën e të dënuarit.

6. Në rast të refuzimit të kërkesës, i dënuari ka të drejtë ankese e cila bëhet sipas procedurës së ankesave të institucionit korrektues.

Neni 49
Rregullat gjatë vizitës në lokalet e veçanta

1. Vizitorët në lokalet e veçanta duhet t'u përmbahen këtyre rregullave:

- 1.1. hapësira e veçantë duhet të shfrytëzohet me mirëbesim si nga i dënuari ashtu edhe nga vizitorët;
- 1.2. vizitat familjare janë të kufizuara brenda lokaleve të veçanta të institucionit korrektues;
- 1.3. vizitorët nuk lejohen që të largohen dhe të rikthehen përsëri gjatë kohës së caktuar për vizitë;
- 1.4. vizitori duhet të respektojë me përpikëri kohën e caktuar për vizitë nga institucioni korrektues.

Neni 50
Ushqimi gjatë vizitës në lokale të veçanta

1. I dënuari dhe vizitori mund të ushqehen brenda lokaleve të veçanta.
2. Ushqimi sigurohet nga kantina e institucionit korrektues ndërsa shpenzimet mbulohen nga i dënuari.

Neni 51
Pastërtia në lokale të veçanta

Institucioni korrektues siguron kushte higjeno-sanitare dhe mundësisht edhe lodra për fëmijë në lokaleve të veçanta.

Neni 52
Thirrjet telefonike

1. Personi i dënuar ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike dhe të komunikojë në forma të tjera të komunikimit elektronik të cilat i ofron institucioni korrektues.
2. Personat e dënuar mund të kryejnë biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Bisedat telefonike kryhen në kabinën telefonike e instaluar në vendin përkatës në institucionin korrektues.
3. Personi i dënuar bisedat telefonike i kryen sipas orarit të përcaktuar.

4. Personi i dënuar nuk mund të thirret me telefon në institucionin korrektues, përveç në rrethanat e jashtëzakonshme (rasti i vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes ose sëmundjet e rënda apo arsyeja tjetër e arsyeshme).

5. Biseda telefonike e personit të dënuar ose të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) minuta, numri i thirrjeve telefonike përcaktohet në bazë të tretmanit.

6. Të paraburgosurit thirrjet telefonike i mundësohen në bazë të lejes së gjykatës për numrat përkatës në përputhje me tretmanin standard.

Neni 53 **Pranimi i pakove ushqimore**

1. Personi i dënuar ka të drejtë të pranojë pako të cilat përmbajnë artikuj ushqimor, një (1) herë në tre (3) muaj, me kusht që këta artikuj ushqimor nuk shërbehen nga kuzhina dhe nuk blihen në kantinë në Institucionet Korrektuese.

2. Pako ushqimore pranohet përmes vizitës familjare. Peshë maksimale e pakos nuk duhet të jetë më shumë se tre (3) kilogram.

3. Pakot ushqimore përdoren nga i dënuari që i dedikohen dhe nuk mund të përdoren nga personat e tjerë. Ushqimi konsumohet gjatë vizitës familjare.

4. Pakot kontrollohen nga zyrtari korrektues në praninë e dorëzuesit.

5. Dorëzuesi i pakos nënshkruan formularin e dorëzimit të pakos dhe mbahet përgjegjës për ndonjë rrezik shëndetësor që mund të vij nga ushqimi që ai ka sjellë nga jashtë.

6. Nëse me pako sjellen artikuj që shërbehen në kuzhinë dhe gjenden në kantinë, nuk do të pranohen.

7. Ndalohen artikujt që paraqesin rrezik për rendin dhe sigurinë në institucionin korrektues dhe janë vështirë për tu kontrolluar.

8. Pako ushqimore nuk pranohet përmes postës.

9. Ky nen nuk zbatohet ndaj të paraburgosurve.

Neni 54 **Kompensimi për punën**

1. Personi i burgosur ka të drejtë në shpërblim mujor për punën e tij.

2. Shpërblimi mujor caktohet në proporcion me kohën dhe cilësinë e punës së kryer.

3. Kategorizimi i profileve të punës dhe paga për punën e kryer përcaktohet me vendim të ministrit.
4. I burgosuri mund të disponoj me 70% të shpërblimit për punën e kryer, kurse pjesa e mbetur ruhet në llogarinë personale të kursimit.
5. Të burgosurit që punojnë jashtë Institucionit Korrektues, mjetet financiare mund t'i shfrytëzojnë sipas kushteve të parapara për shumën e lejuar për blerje në kantinë.
6. Drejtori i Institucionit Korrektues mund të lejojë shpenzimin e mjeteve nga llogaria e ruajtjes së parave të kursimit, nëse ato janë të domosdoshme për personin e burgosur, ose për familjen e tij.

KAPITULLI VI

LLOJET KUSHTET DHE MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË BENEFICIONEVE

Neni 55

Llojet e benificioneve

1. Për sjellje të mirë, angazhim në punë dhe zbatimin e planit individual të dënimit, Drejtori i Institucionit Korrektues, pas marrjes së rekomandimit të ekipit multidisiplinor mund të jap benificionet vijuese personit të dënuar:
 - 1.1. I dënuari mund të pranojë një (1) vizitë më shumë në muaj, edhe nga rrethi i gjerë i personave;
 - 1.2. Pranimin e vizitave në institucionin korrektues në prani të mbikëqyrësve, por pa u dëgjuar nga ata;
 - 1.3. Të dënuarit mund t'i jepet një (1) vizitë më shumë në lokale të veçanta me bashkëshortin/bashkëshorten.
 - 1.4. Të dënuarit mund t'i jepet një (1) vizitë më shumë për kalimin e kohës në lokale të veçanta me fëmijët dhe prindërit.
 - 1.5. I dënuari mund të shfrytëzoj pushimin e rregullt jashtë institucionit korrektues më së shumti katërmbëdhjetë (14) ditë në vit.

Neni 56

Kriteret për lejimin e benificioneve

1. Pushimi jashtë Institucionit Korrektues, deri në katërmbëdhjetë (14) ditë brenda një (1) viti nga i dënuari mund të shfrytëzohet vetëm pas mbajtjes së një të dytës (1/2) të dënimit me burgim.

- 1.1. Shfytëzimi i pushimit jashtë Institucionit Korrektues bëhet sipas planit për shfytëzimin e pushimit të cilin e miraton Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues i Kosovës.
2. I dënuari i cili është në një procedurë tjetër gjyqësore, si dhe i dënuari që është në pritje të transferimit apo ekstradimit përjashtohet nga mundësia e shfytëzimit të beneficioneve.
3. Beneficionet e përcaktuara në këtë Udhëzim nuk mund të shfrytëzohen jashtë territorit të Republikës së Kosovës, përjashtimisht shfrytëzimi i pushimit jashtë territorit të Republikës së Kosovës mund të lejohet nëse ekzitojnë marrëveshje ndërshtetërore për këtë çështje.
4. I dënuari duhet të jetë në tretman të avancuar dhe të mos ketë masë disiplinore në vitin e fundit për shkelje të rëndë dhe gjashtë (6) muajt e fundit për shkelje të lehtë.
5. I dënuari duhet të mos jetë i klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë.
6. Kriteret e përgjithshme të përcaktuara për realizimin e vizitave të rregullta zbatohen edhe për beneficionin e vizitave shtesë të përcaktuara në nenin 58, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4, të këtij Udhëzimi.

Neni 57 Aplikimi

1. I dënuari i cili aplikon për herë të parë për shfytëzimin e pushimit jashtë Institucionit Korrektues duhet që kërkesën ta parashtrij tridhjetë (30) ditë para se ai/ajo të dëshiroj ta realizoj pushimin jashtë institucionit korrektues.
2. I dënuari i cili aplikon për shfytëzim të pushimit jashtë Institucionit Korrektues pas herës së parë, kërkesën e parashtron pesëmbëdhjetë (15) ditë, para se ai/ajo dëshiron të realizojë pushimin jashtë institucionit korrektues.

Neni 58 Autoriteti lejues

1. Drejtori i institucionit korrektues vendos nëse të dënuarit i lejohet pushimi jashtë institucionit korrektues.
2. Drejtori i institucionit korrektues vendos për lejimin e pushimit jashtë institucionit korrektues duke marrë parasysh faktorët siç janë:
 - 2.1. veprën penale për të cilën i dënuari mban dënimin me burgim;
 - 2.2. qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale;
 - 2.3. sjelljen e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit;

2.4. rrezikun e moskthimit dhe rrezikun e mundshëm për shoqërinë;

2.5. historinë familjare dhe kontaktet familjare të personit të dënuar.

2.6. informatat e siguruara që mund të tregojnë se personi i dënuar apo personat e tjerë janë të rrezikuar.

Neni 59

Vendosja për kërkesën për lejimin e pushimit

1. Kur personi i dënuar parashtron kërkesë për lejimin e pushimit për herë të parë, Institucioni Korrektues vendos lidhur me kërkesën brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës.

2. Kur personi i dënuar parashtron kërkesë për lejimin e pushimit pas herës së parë, Institucioni Korrektues vendos lidhur me kërkesën brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës.

3. Përbashimisht nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, në raste të veçanta kur kërkohen informacione shtesë, Institucioni Korrektues me arsyetim të drejtorit mund të shtyjë afatin edhe pesëmbëdhjetë (15) ditë të tjera.

4. Drejtori i institucionit korrektues për pushimin e të dënuarit jashtë Institucionit Korrektues, së paku tri (3) ditë para pushimit të dënuarit, e njofton Qendrën Operative të Shërbimit Korrektues dhe Policinë e Kosovës.

Neni 60

Kushtet e përcaktuara nga drejtori i Institucionit Korrektues

1. Për lejimin e pushimit jashtë institucionit korrektues, drejtori i institucionit korrektues përcakton kushtet e veçanta, të cilat duhet të pranohen me shkrim dhe nënshkruhen nga i dënuari para se kërkesa të lejohet.

2. Kushtet e përcaktuara nga drejtori i institucionit korrektues përfshijnë por nuk kufizohen në:

2.1. mos pjesëmarrja në aktivitete të paligjshme dhe mos përdorimi i drogës dhe alkoolit;

2.2. kufizimet se ku i dënuari mund të udhëtoj gjatë pushimit jashtë institucionit korrektues;

2.3. kufizimet se kënd i dënuari mund të kontaktoj gjatë pushimit jashtë institucionit korrektues;

2.4. raportime periodike në polici gjatë pushimit jashtë institucionit korrektues;

2.5. kërkesë që i dënuari të përcjellët nga Shërbimit Korrektues i Kosovës, apo Policia e Kosovës në raste të jashtëzakonshme.

Neni 61 **Pushimi vjetor**

1. I dënuari ka të drejtë në pushim vjetor prej njëzet (20) ditësh brenda vitit.
2. I dënuari i cili ka punuar pa ndërprerë më shumë se gjashtë (6) muaj e fiton të drejtën e shfrytëzimit pushimit vjetor.
3. Kompensimi për pushim të dënuarve përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 62 **Mënyra e shfrytëzimit të pushimit vjetor**

1. Shfrytëzimi i pushimit vjetor për personin e dënuar bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës në fuqi të punës.
2. I dënuari mund të shfrytëzojë pushimin vjetor, në bazë të lejes së drejtorit të institucionit korrektues.
3. Të burgosurit pushimet vjetore i kalojnë në lokalet e institucionit korrektues. Gjatë kësaj kohe ata mund të merren me aktivitete të ndryshme kulturore, argëtuese dhe sportive. Përjashtimisht të dënuarit mund të shfrytëzojnë pushimin vjetor jashtë Institucionit Korrektues në pajtim me nenin 56 të këtij udhëzimi.

Neni 63 **Pushim për raste të jashtëzakonshme**

1. Të dënuarit mund t'i jepet pushim i jashtëzakonshëm në rast të sëmundjes së rëndë, ose rrezikut të drejtpërdrejtë të vdekjes, apo të vdekjes së një anëtari të familjes.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni pushimi i jashtëzakonshëm mund të jepet për raste të rënda personale ose familjare;
3. Për realizimin e pushimit të jashtëzakonshëm në rast të sëmundjes nga familjarët duhet të sillen një (1) dëshmi nga tre (3) profesionistë mjekësorë.
4. Pushimi për raste të jashtëzakonshme nuk duhet të jetë më shumë se shtatë (7) ditë brenda një viti.
5. Drejtori i institucionit korrektues mund të lejoj një pushim të shkurtër me përcjellës të dënuarit, i cili nuk është shfrytëzues i pushimit në shtëpi. Kohëzgjatja e kësaj përcjellje jashtë

institucionit korrektues nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë (6) orë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes apo sëmundjes së rëndë të anëtarit të ngushtë në familje.

KAPITULLI I VII

MBATJA E RENDIT DHE DISIPLINËS, SISTEMI I SHKELJEVE DISIPLINORE DHE TË SANKSIONEVE, KUSHTET DHE MËNYRA E APLIKIMIT TË MASAVE DISIPLINORE

Neni 64

Shkeljet dhe dënimet disiplinore

1. Disiplina dhe mbajtja e rendit organizohen me qëllim të vetëdijesimit dhe inkurajimit që të burgosurit të sillen në mënyrë korrekte për mbajtjen e rendit dhe disiplinës në institucionet korrektuese.
2. Masat disiplinore përcaktohen me Ligjin dhe duhet të jetë në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes.
3. Para se të iniciohet procedurë disiplinore çdo herë kur është e mundur, organet e institucioneve korrektuese i japin përparësi mundësisë së ndërmjetësimit për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të burgosurve, në mënyrë që t'i shmangen inicimit të procedurës disiplinore.
4. Çdo masë dhe procedurë disiplinore duhet të ruaj interesin e sigurisë dhe të jetë në përputhje me ruajtjen e dinjitetit të të dënuarve. Masat disiplinore zbatohen duke respektuar personalitetin e të dënuarit.
5. Disiplina e të paraburgosurve përcaktohet edhe me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 65

Llojet e shkeljeve disiplinore

1. Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.
2. Personi i dënuar kryen shkelje të lehtë disiplinore kur:
 - 2.1. nuk respekton urdhrin e arsyeshëm të anëtarit të personelit të institucionit korrektues;
 - 2.2. qëndron në zonë të ndaluar për personat e dënuar pa leje;
 - 2.3. manifeston sjellje të pahijshme dhe fyen anëtarin e personelit të institucionit korrektues;

2.4. manifeston sjellje të pahijshme dhe fyen cilindo person në mënyrën e cila mund të provokojë personin tjetër të jetë i dhunshëm;

2.5. refuzon, apo i shmanget punës, ose nuk paraqitet në punë pa ndonjë shkak të arsyeshëm;

2.6. merret me bixhoz;

2.7. me vetëdije nuk i respekton rregullat e shkruara, me të cilat rregullohet sjellja e personave të dënuar; ose

2.8. tenton të kryejë apo t'i ndihmojë personit tjetër në kryerjen e ndonjërit prej veprimeve nga nën paragrafët 2.1 deri 2.7. të këtij paragrafi.

3. Personi i dënuar kryen shkelje të rëndë disiplinore nëse:

3.1. rrah, sulmon, ose kërcënon se do të sulmojë personin tjetër;

3.2. me vetëdije, apo nga pakujdesia e dëmton, ose e shkatërron pasurinë që nuk është e tij;

3.3. kryen vjedhje;

3.4. nëse posedon pasuri të vjedhur;

3.5. ofron, jep, ose merr ryshfet, apo shpërblim;

3.6. është në posedim, ose merret me sendin e palejuar;

3.7. pa leje konsumon narkotikë të rrezikshëm, substancë psikotrope, apo alkool;

3.8. krijon, apo merr pjesë në ndonjë trazirë, ose në ndonjë aktivitet tjetër i cili mund të rrezikojë mbrojtjen dhe sigurinë në institucionit korrektues;

3.9. kryen veprime përgatitore me qëllim të arratisjes;

3.10. ikë, ose largohet nga institucioni korrektues, ose pa leje nuk kthehet në të.

Neni 66 **Dënimet disiplinore**

1. Shkeljet disiplinore ndëshkohen me dënime disiplinore.

2. Dënimet disiplinore janë:

2.1. qortimi;

2.2. heqja e përkohshme e beneficionit të caktuar;

2.3. urdhri për kompensim dhe

2.4. vetmia.

Neni 67 **Dënimet për shkelje të lehtë disiplinore**

1. Të dënuarit, të cilit i është shqiptuar masë disiplinore për shkelje të lehtë disiplinore, mund t'i shqiptohet një ose me shumë nga masat, si në vijim:

1.1. qortim;

1.2. humbjen e beneficioneve deri në dyzet e pesë (45) ditë;

1.3. urdhër për kompensim nga llogaria e tij bankare për një periudhë të caktuar kohore.

Neni 68 **Dënimet për shkelje të rëndë disiplinore**

1. Të dënuarit, të cilit i është shqiptuar masë-shkelje të rëndë disiplinore, mund t'i shqiptohet njëra nga masat si në vijim:

1.1. humbje të beneficioneve deri në gjashtë (6) muaj;

1.2. dëmshpërblim në vlerë deri në njëqind (100) Euro, tërheqja nga llogaria e tij bankare bëhet me këste, maksimumi i kështit është njëzetë e pesë (25) euro;

1.3. Vetmi deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë për secilën shkelje disiplinore.

2. Dënimet disiplinore nuk duhet të përmbajnë trajtim ç'njerëzor apo degradues, duke përfshirë ndëshkimin fizik, vendosjen në një qeli të errët, apo ndëshkim që mund të dëmtoj shëndetin fizik apo mendor të personit të dënuar.

Neni 69 **Shqiptimi i urdhrit për kompensim**

Urdhri për kompensim për shkelje të lehtë dhe të rëndë disiplinore mund të shqiptohet krahas dënimeve tjera të parapara në Ligj.

Neni 70

Masa e vetmisë

1. Para se të urdhërohet për ndëshkim me vetmi, Drejtori i Institucionit Korrektues, duhet të merr me shkrim mendimin e mjekut, i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore, fizike dhe psikike.
2. I dënuari i cili dërgohet në vetmi si masë ndëshkuese duhet të vizitohet nga mjeku menjëherë pas dërgimit. Mjeku i institucionit korrektues është i obliguar që me shkrim, ta njoftoj drejtorin e institucionit korrektues lidhur me gjendjen shëndetësore dhe psikike të dënuarit në vetmi dhe të jep vlerësimin e tij.
3. Drejtori i institucionit korrektues, bazuar në vlerësimin e mjekut, merr vendim lidhur me vazhdimin ose jo të vetmisë së të dënuarit.
4. Kur për të burgosurin vendoset mbajtja në vetmi si pasojë e një dënimi të mëparshëm të mbajtjes në vetmi, duhet të specifikohet nëse të dy periudhat duhet të mbahen njëra pas tjetrës apo të bëhet unifikimi i tyre.
5. Nëse masa e vetmisë mbahen njëra pas tjetrës, koha e përgjithshme e ndarjes që i shqiptohet nga masa nuk duhet të jetë më gjatë se tridhjetë (30) ditë.
6. Kur që të dy masat e vetmisë kanë për qëllim humbjen e privilegjeve të tjera, privilegjet e humbura duhet të përcaktohen si pjesë e sanksionit të plotë të shkeljes.
7. I dënuari nuk duhet të vendoset në vetmi për një periudhë kohore prej më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë gjatë një viti kalendarik.
8. Nëse gjatë kohës së mbajtjes së vetmisë, mjeku informon drejtorin e institucionit korrektues për përkeqësim të gjendjes së të burgosurit, drejtori i institucionit korrektues merr në konsideratë këtë vlerësim dhe merr vendimin e nevojshëm.

Neni 71

Kushtet në dhomën e vetmisë

1. Qelia e vetmisë duhet të ketë tualet, ujë, lavaman, dritë të mjaftueshme natyrale, shtrat, tavolinë dhe karrige statike.
2. Çdo send që konsiderohet i rrezikshëm nuk lejohet në dhomën gjatë qëndrimit në vetmi.
3. Të dënuarit në vetmi kanë të drejtë për:
 - 3.1. të njëjtat kushte higjienike dhe shëndetësore sikur të burgosurit tjerë;
 - 3.2. një vizitë të mbyllur, nga bashkëshorti/bashkëshortja ose anëtarë tjerë të familjes, në periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve;
 - 3.3. qasje në libra dhe shkrim; dhe

3.4. qëndrimi jashtë ambientit të mbyllur së paku një (1) orë në ditë.

4. I burgosuri në vetmi duhet të vizitohet nga personeli mjekësor çdo ditë si dhe nga drejtori i institucionit korrektues një herë në shtatë (7) ditë, varësisht nga nevoja edhe më shpesh, ndërsa zyrtari social të paktën një herë në 3 ditë.

5. Të dënuarit të mitur nuk mund t'i shqiptohet masa disiplinore e vetmisë.

KAPITULLI VIII ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE KULTURORE, ARSIMORE, SPORTIVE DHE ARGËTUESE

Neni 72 Organizimi i aktiviteteve

1. Institucioni korrektues organizon aktivitete kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese për riintegrimin dhe risocializimin e personave të dënuar në shoqëri sipas programit dhe trajtimit të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

2. Për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni institucioni korrektues duhet të siguroj hapësira dhe pajisje të nevojshme.

Neni 73 Pjesëmarrja në aktivitete

Procesi i aktiviteteve përfshin edhe programe të trajtimit në grup të dënuarve, duke ju dhënë mundësi atyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të institucionit, të cilat i ndihmojnë ata të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe të nxisin interesin për arsimim, formim profesional, veprimtari kulturore, sportive dhe të punës.

Neni 74 Shërbimi bibliotekar

1. Në çdo institucion korrektues duhet të ketë një bibliotekë për përdorim nga të gjithë të burgosurit.

3. Shërbimi i bibliotekës organizohet dhe mbikëqyret nga personeli përgjegjës, i cili kujdeset për mirëmbajtjen dhe pasurimin e saj, shpërndarjen e literaturës dhe përhapjen e dijes dhe të kulturës.

3. Në përzgjedhjen e literaturës duhet pasur parasysh sigurimi sa më i mirë i pluralizmit shkencor, kulturor dhe artistik.

4. Çdo bibliotekë në institucion korrektues duhet të ketë literaturë për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, legjislacionin bazë penal, procedural penal dhe në fushën e trajtimit të dënuarve.

Neni 75

Kujdesi social

1. Trajtimi i të burgosurve bëhet në përputhje me kapacitetin, arsimin, gjendjen socialo-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë.

2. Për realizimin e rehabilitimit social të të burgosurve, institucioni korrektues duhet të vë në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme, duke realizuar përkrahjen morale, kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin fizik, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta dhe nxitjen e kontakteve pozitive me jashtë, në mënyrë që të zgjerohet perspektiva e riintegritit shoqëror pas lirimit.

Neni 76

Arsimimi

1. Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Shërbimi Korrektues është përgjegjës për caktimin e lokacionit dhe infrastrukturës ku do të zhvillohet mësimi.

1. Përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është Ministria përkatëse për Arsim.

Neni 77

Aftësimet profesionale

1. Në institucionin korrektues organizohen kurse për përgatitjen profesionale të të dënuarve.

2. Mësimdhënia në këto kurse realizohet në institucionin korrektues ose jashtë tij nga profesionistë, të cilët përzgjedhen dhe autorizohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

3. I dënuari inkurajohet për vijimin e kurseve të formimit profesional. Vijimi i kurseve arsimore bëhet gjatë orarit të punës. Personi i dënuar që nuk punon për shkak të vijimit të kurseve arsimore ka të drejtë në kompensim.

KAPITULLI IX LIRIMI I TË DËNUARVE

Neni 78 Përgatitja e të dënuarve për lirim

1. Institucioni korrektues në pajtim me parimet themelore, që nga fillimi i mbajtjes së dënimit duhet të ndërmarrë veprime për përgatitjen e të dënuarit për jetë në liri.
2. Gjatë kohës së mbajtjes së dënimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e dënimit dhe mundësitë risocializuese, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para lirit të dënuarit, zyrtarët kompetent, marrin masa dhe zhvillojnë një program të veçantë trajtimi para lirit.
3. Personeli përkatës i institucionit korrektues komunikon dhe bashkëbisedon me të dënuarin për problemet me të cilat mund të ballafaqohet pas lirit, si dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse të vendbanimit të dënuarit.
4. Për realizimin e këtij procesi, personeli i institucionit korrektues duhet të bashkëpunojë edhe me subjekte, shoqata të ndryshme të interesuara, Shërbimin Sprovues, e në veçanti ata që kanë objekt të veprimtarisë së tyre çështjet sociale, familjare dhe punësimin.

Neni 79 Lirimi i të dënuarit

Drejtori i Institucionit Korrektues nxjerr fletlëshim për lirimin e të dënuarit. Për të dënuarit të cilët nuk kanë mjete financiare dhe veshmbathje, drejtori i institucionit korrektues mund të nxjerrë urdhrin, me të cilin i jepet ndihmë financiare dhe veshmbathje të dënuarit, në varësi të kushteve ekonomike, familjare, gjendjes financiare në llogarinë personale të tij, largësisë së vendbanimit nga institucioni korrektues.

Neni 80 Ankesat dhe kërkesat

Institucioni Korrektues të burgosurit i siguron të drejtën në ankesa dhe kërkesa në pajtim me nenin 90 të Ligjit.

KAPITULLI X DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 81 Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen:

1.1.Udhëzim administrativ MD-Nr.07/2015 Për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese;

1.2.Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 05/2014 për Kushtet Higjiene Sanitare për personat e dënuar.

2.Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet çdo dispozitë tjetër e akteve nënligjore që është në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 82
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetë Zyrtare.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

15/09/2023